PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 12.05.2026

Sot në sallën e mbledhjeve të KB Devoll u zhvillua mbledhja jashtë radhe sipas njoftimit të datës 07.05.2026.

Të pranishëm në sallë: Alfredi Gjata, Vladimir Kello, Oliver Mulla, Festim Kaso, Kledi Cenkolli, Arsina Mazelliu, Oljana Çonka, Imelda Çuçka, Valbona Spaho, Ilir Hoxha, Gela Hoxhalli.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 1. Miratimi i rendit të ditës.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 2. Miratimi i procesverbalit të datës 30.04.2026.

Hapet votimi: 11 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojmë me Projekt-Vendimin e vetëm që kemi për këtë mbledhje.

PV, Nr. 43 datë 06.05.2026 "Për vijimin e procedurës së shpronësimit të miratuar me vendimin Nr.52 datë 26.06.2020 "Për fillimin e procedurave për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i rrugëve vendore lagjia Nr.2 dhe 3 dhe zgjerimi i rrugëve vendore aks Superstrada e Devollit-Ismail Qemali, Demir Progri, aks rruga Etem Osman Xhaci" dhe miratimi i vlerave për subjektet që preken nga shpronësimi."

Eriksela Avdo: Ne kemi depozituar pranë Agjencisë Shtetërore kërkesën për shpronësim për projektin që kemi pasur për rrugët që janë realizuar nga Bashkia Devoll. Besoj shumë nga ju e mbajnë mend, kjo procedurë është futur herë pas here në Këshill. Pas dorëzimit ka ardhur dhe përgjigjja e tyre ka kërkuar plotësim të disa dokumentacioneve që mungonin. Një ndër to ishte përditësimi i procedurës. Një pikë tjetër është llogaritja e vlerave, jo për të gjitha vlerat të jenë jo sipas VKM 89.

Pra, jemi përpara PV i cili kërkon miratimin tuaj për përditësim dhe përllogaritje të vlerave sipas kësaj VKM.

Alfredi Gjata:

Hapet votimi: 10 pro, 1 kundër, 0 abstenim

Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Alfredi Gjata

Kostandina Brahollu